

Partia Demokratike
Dega Roskovec

Roskovec, më 17 /03/2021

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: Partia Demokratike Dega Roskovec

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale ,328/a “Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike” dhe 329 “Kanosja e zgjedhësit”.

KUNDËR: [REDAKTUAR] me detyrë Drejtoreshë e Shkollës [REDAKTUAR]
[REDAKTUAR]

DREJTUAR: Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280, 283 të K.Pr.Penale, si dhe neneve 328/a dhe 329 të Kodit Penal, parashtrojmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 parashikon se:

Neni 280

Marrja dijëni për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijëni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve

Çdo person që ka marrë dijëni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.